

Sherr për pronën, kapet autori që tentoi të vriste me armë zjarri të riun në Tiranë



© 09:28 - 16 Dhjetor, 2022



Ka rënë në prangat e policisë 46-vjeçari që tentoi të vriste me armë zjarri (pushkë) për motive pronësie një shtetas 27-vjeçar në fshatin Arbanë Tiranë.

Burime për ABC News bëjnë me dije se i arrestuari është Gazmend Xhabafti, banues në Vaqarr.

Uniformat blu bëjnë me dije se arrestimi i 46-vjeçarit u bë në kuadër të operacionit policor të koduar “Arbana”.



Ndaj 46-vjeçarit rëndojnë akuzat për veprat penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

Shtetasi G. Xh. ka tentuar të vrasë me armë zjarri shtetasin J. M., 27 vjeç, të dy banues në fshatin Arbanë, për shkak të një konflikti për motive pronësie, në muajin shtator. Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në vendin e ngjarjes, kanë gjetur armën e zjarrit pushkë, me fishek në fole, gati për qitje, me të cilën shtetasi G. Xh. ka tentuar të vrasë 27-vjeçarin.

Njoftimi i policisë

Tiranë/Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 6, operacioni policor i koduar “Arbana”.

Tentoi të vriste me armë zjarri, një shtetas, për motive pronësie, kapet dhe vihet në pranga 46-vjeçari i shpallur në kërkim.

Sekuestrohen arma e zjarrit (pushkë), municion luftarak, një silenciator i modifikuar, një palë dylbi dhe një armë gjahu, që i posedonte 46-vjeçari.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërisë, kapjen e personave në kërkim dhe vënien e tyre përpara përgjegjësisë penale, bazuar dhe në informacionet e siguruaru nëpërmjet inteligjencës informative, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Arbana”.

Si rezultat i këtij operacioni është bërë kapja dhe ndalimi i shtetasit:

G. Xh., 46 vjeç, banues në Vaqarr, për veprat penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

Shtetasi G. Xh. ka tentuar të vrasë me armë zjarri shtetasin J. M., 27 vjeç, të dy banues në fshatin Arbanë, për shkak të një konflikti për motive pronësie, në muajin shtator. Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në vendin e ngjarjes, kanë gjetur armën e zjarrit pushkë, me fishek në fole, gati për qitje, me të cilën shtetasi G. Xh. ka tentuar të vrasë 27-vjeçarin.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të banesës së 46-vjeçarit, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale municion luftarak, një silenciator të modifikuar, një palë dylbi dhe një armë gjahu.

/abcnews.al/

- *Kryesore
- Aktualitet
- Kapet Autori Që Tentoi Të Vriste Me Armë Zjarri Të Riun Në Tiranë
- Sherr Per Pronen

Të ngjashme

“Është shtëpia e mbesës time”, sherr për pronën në Pogradec, dy gratë konfliktohen me njëra... tjetrën



Minute pas minute



© 11:16
Kate Middleton shfaqet me një pamje elegante për festa, të gjithë...



© 11:08
Jose Mourinho hesht për të ardhmen e tij



© 11:05
Henry Cavill nuk do të jetë me Superman



© 10:58
Vrau ish-vjehrrin dhe kunatin në Lezhë, arrestohet pas disa...



© 10:55
Fjoralba Ponari flet “troç”: Çfarë do të bëja nëse do më shkruant...



Albania për
Shërbime
Të Re

ARTIKULL JOETIK?

© 11:16 - 16 Dhjetor, 2022

Kate Middleton shfaqet me një pamje elegante për festa, të gjithë vemendje...

© 11:08 - 16 Dhjetor, 2022

Jose Mourinho hesht për të ardhmen e tij

© 11:05 - 16 Dhjetor, 2022

Henry Cavill nuk do të jetë me Superman

© 10:58 - 16 Dhjetor, 2022

Vrau ish-vjehrrin dhe kunatin në Lezhë, arrestohet pas disa muaj...

© 10:55 - 16 Dhjetor, 2022

Fjoralba Ponari flet “troç”: Çfarë do të bëja nëse do më shkruante ish i dashuri

© 10:55 - 16 Dhjetor, 2022

Përfitoi nga kaosi pas vetëvrasjes së një polici, shqiptari arratiset nga...

© 10:54 - 16 Dhjetor, 2022

Lufta që zgjati vetëm 6 ditë

© 10:53 - 16 Dhjetor, 2022

Aksident në rrugën Lezhë-Shëngjin, lëndohet shoferi i motorit

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

Harta e faqes

Aktualitet	Botë	English
Politikë	Ekonomi	Life
Rajon	Emisione	Plus
Sport	Moti	

